

**SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË**  
**SH.K.F.SH**

**STATUTI**

Funksioni propozues	<b>Këshilli Drejtues</b>
Funksioni aprovues	<b>Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve</b>
Data e aprovimit	<b>24.10.2020</b>

Neni 1  
**Shoqata**

1. Shoqata mban emrin Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (në vijim “Shoqata”). Emërtimi i shkurtuar i Shoqatës është **SH.K.F.SH**.
2. SH.K.F.SH është person juridik i regjistruar si organizatë jofitimprurëse me anëtarësi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin e saj Nr. 432, datë 10 shkurt 1998.
3. Selia e Shoqatës ndodhet në Tiranë. Adresa aktuale e Shoqatës është: *Bulevardi “Bajram Curri”, Pallati 172, Ap. 5, Tiranë*. Selia e Shoqatës mund të ndryshohet me vendim të Këshillit Drejtues.
4. Shoqata mban stemën e përbërë nga inicialet e shoqatës në germa kapitale (SH.K.F.SH), përreth së cilave vijnë dy gjysmë harqe, ngjyrë kuq e blu.

Neni 2  
**Përkufizime**

1. Në këtë Statut, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a. “Anëtar” është individi ose shoqëria e kontabilitetit e anëtarësuar në Shoqatë në përputhje me parashikimet në Statut dhe/ose rregulloret e Shoqatës, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
  - b. “Bordi i Mbikëqyrjes Publike” është organi publik i mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, i cili gjithashtu ka kompetenca edhe për mbikëqyrjen e organizmave profesionale të kontabilistëve të miratuar.
  - c. “Degë” është grupimi i anëtarëve të Shoqatës brenda një zonë të përcaktuar gjeografike, të autorizuara për të kryer veprimtaritë e Shoqatës dhe arritjen e objektivave të Shoqatës në atë zonë gjeografike (bashki ose qark).
  - d. “Kandidat” është anëtari i Shoqatës, që në momentin e anëtarësimit gëzon zotësi të plotë për të vepruar, nuk është dënuar penalisht ose me dënim plotësues të natyrës, që vë në dyshim ndershmërinë e tij dhe ka përfunduar studimet universitare të ciklit të parë ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si: Kontabilitet, Financë, Administrim Biznesi, Ekonomiks apo fusha të lidhura ose të ngjashme.
  - e. “Kontabilist i Miratuar” është personi fizik, i regjistruar në regjistrin publik të një organizate profesionale të kontabilistëve të miratuar dhe të njohur nga Bordi i Mbikëqyrjes

Publike, që përmbush kushtet e nenit 49 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i cili mban statusin Aktiv ose Joaktiv sipas përcaktimeve ligjore dhe vepron në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, me këtë Statut dhe Kodin e Etikës së Shoqatës së Kontabilistëve dhe të Financierëve të Shqipërisë (SH.K.F.SH).

- f. “Komisioni Disiplinor” është struktura përgjegjëse e SH.K.F.SH për investigimin dhe vendosjen e masave disiplinore ndaj anëtarëve ose joanëtarëve në përputhje me Statutin dhe rregulloren e referuar në Nenin 30 në këtë Statut.
- g. “Komision i provimeve të aftësive profesionale” është struktura që merret me testimet e kandidatëve për auditues ligjorë dhe kontabilistë të miratuar, të cilat organizohen në kuadër të provimit përfundimtar, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse.
- h. “Kualifikim i vijueshëm profesional” është procesi i edukimit të detyrueshëm që çdo Kontabilist i Miratuar duhet të kryejë çdo vit në përputhje me këtë Statut dhe ligjin Nr. 10091, datë 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar.
- i. “Kursët e Kualifikimit” janë kurset e zhvilluara në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, të raportimit financiar apo të fushave të tjera të lidhura me to, si dhe kurset e tjera profesionale që realizon Shoqata për kandidatët që kërkojnë të fitojnë titullin “Kontabilist i Miratuar” apo për anëtarësinë e saj.
- j. “Mbledhja” ose “Mbledhja e Asamblesë” është mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme Vjetore e Anëtarëve të Shoqatës ose Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve të Shoqatës, siç përcaktohet në këtë Statut.
- k. “Ligji për auditimin ligjor”, është Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”.
- l. “Shoqëri kontabiliteti” janë shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime kontabiliteti.
- m. “Organizata profesionale të kontabilistëve të miratuar” janë organizimet e profesionistëve kontabilistë, në kuptimin e Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009.
- n. Me “ditë”, “muaj”, “vit/e”, do të kuptohet ditë, muaj ose vit/e kalendarike.
- o. Statut/i është statuti i “Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë”.

Neni 3

**Baza ligjore e veprimtarisë së Shoqatës**

1. Shoqata është e organizuar dhe funksionon si organizatë profesionale e kontabilistëve të miratuar apo profesionistëve të tjerë të kësaj fushe, në shërbim të profesionit dhe praktikës së kontabilitetit dhe fushave të lidhura në përputhje me Ligjin “Për auditimin ligjor” i ndryshuar, Ligjin Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, legjislacionin e aplikueshëm shqiptar.

#### Neni 4

#### Anëtarësimi në Shoqatë

1. Anëtar i Shoqatës mund të jetë:
  - a) Individ i që gëzon titullin “Kontabilist i Miratuar”;
  - b) Shoqëria e Kontabilitetit;
  - c) Kandidati që aderohet për të marrë titullin “Kontabilist i Miratuar”;
  - d) Çdo profesionist që plotëson kushtet e nenit 2, pika 1, germa ‘a’.
2. Kërkesa për t’u anëtarësuar në Shoqatë paraqitet me shkrim dhe bashkëlidhet me kopjet e dëshmive që vërtetojnë përfitimin e titullit “Kontabilist i Miratuar”, kopje të noterizuara të vërtetimit të provimeve ose të dokumentit përkatës të parashikuar dhe të lëshuar nga ana e autoritetit të certifikimit, diploma, dokumentit të identifikimit, si dhe dy fotografi.
3. Formati i kërkesës dhe përmbajtja përcaktohen nga Këshilli Drejtues.
4. Anëtarët paguajnë kuotat e anëtarësisë në Shoqatë të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe çdo tarifë regjistrimi apo detyrim tjetër të aplikueshëm.
5. Anëtari pushon së qeni anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, kur:
  - a) kërkon të largohet nga Shoqata, pasi ka përmbushur kushtet e nenit 31, pika 2;
  - b) nuk plotëson kushtet sipas Ligjit “Për Auditimin Ligjor”, Statutit të Shoqatës dhe rregulloreve të saj;
  - c) kryen veprime në kundërshtim me Kodin e Etikës, Statutin ose dispozitat ligjore.
  - d) ndaj tij/saj merret masa disiplinore e përjashtimit nga Shoqata me vendim të Këshillit Drejtues.
6. Procedura më të detajuara në përputhje me pikën 5 më sipër, për paraqitjen e kërkesës, pezullimin e anëtarësisë, çregjistrimin nga regjistrat apo përjashtimin nga Shoqata, përcaktohen në “Rregulloren e Regjistrimit të Anëtarëve” dhe “Rregulloren e Procedimit Disiplinor”, të miratuar nga Këshilli Drejtues në përputhje me parimet dhe rregullat në Statut.

#### Neni 5

### Anëtarësimi dhe regjistrimi i shoqërive të kontabilitetit

1. Shoqëritë e kontabilitetit anëtarësohen në Shoqatë dhe regjistrohen në seksionin përkatës të Regjistrimit të Kontabilistëve të Miratuar të Shoqatës, nëse plotësojnë kërkesat ligjore dhe rregullatore të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, parashikimet e Statutit, vendimet e Shoqatës, si dhe kushtet në vijim:
  - a) shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë së kontabilitetit zotërohen nga shoqëri kontabiliteti, vendase ose të huaja, ose nga kontabilistë të miratuar;
  - b) të paktën 50 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë së kontabilitetit janë Kontabilistë të Miratuar, të njohur nga Komiteti i Regjistrimit i Shoqatës dhe të regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar të saj.
  - c) Shoqëria angazhon Kontabilistë të Miratuar, të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar.
2. Këshilli Drejtues mund të vendosë rregulla shtesë për anëtarësimin e shoqërive të kontabilitetit për shkak të ndryshimeve ligjore e rregullatore ose nën diskrecionin e vet.

#### Neni 6

### Objekti i veprimtarisë

1. Shoqata ka si objekt të saj:
  - (i) Të jetë një organizatë përfaqësuese e Kontabilistëve të Miratuar, kandidatëve për t'u bërë Kontabilistë të Miratuar, si edhe e profesionistëve dhe personave me interes në fushën e kontabilitetit dhe fushat e lidhura me të.
  - (ii) Të ushtrojë funksionin e mbikëqyrjes së profesionit të kontabilistit të miratuar në përputhje me Ligjin Nr. 10091, "Për auditimin ligjor" dhe rregulloret përkatëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
  - (iii) Pa paragjykuar objektin e pikës (ii) më sipër, të promovojë dhe të mbështesë studimet në fushën e kontabilitetit dhe të gjenerojë udhëzime, dije dhe njohuri mbi praktikën e kontabilitetit dhe praktikatat e fushave të tjera të lidhura;
  - (iv) Të promovojë, përvetësojë dhe të çojë më tej standardet e aftësisë profesionale të anëtarëve dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të mbajtur lart standardet teknike dhe etike të anëtarëve të saj.
  - (v) Të mbikëqyrë anëtarët e Shoqatës në zbatimin e rregullimeve ligjore në fushën e kontabilitetit, të rregullimeve dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe më gjerë, për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të kontabilitetit dhe fushave të lidhura.

- (vi) Të sigurojë njohjen e Shoqatës nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike si organizatë profesionale e kontabilistëve të miratuar në përputhje me Ligjin Nr. 10091 dhe rregulloret përkatëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të arritur këtë qëllim;
- (vii) Të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare të profesionit dhe të përmbushë detyrimet që vijnë nga anëtarësimi;
- (viii) Të miratojë rregulla e rregullore për të siguruar përmbushjen e standardeve e detyrimeve profesionale të anëtarëve të Shoqatës;
- (ix) Të japë vlerësime dhe këshilla, të organizojë diskutime dhe forume mbi çdo çështje që prek praktikën e kontabilitetit dhe fushave të lidhura me to dhe të kontabilistëve të miratuar, anëtarë të Shoqatës ose jo;
- (x) Të mbështesë dhe të mbrojë figurën, statusin, të drejtat dhe interesat e kontabilistëve të miratuar, kandidatëve për kontabilistë të miratuar apo profesionistëve të tjerë, anëtarë të Shoqatës ose jo, dhe të promovojë praktikat e mira të profesionit;
- (xi) Të botojë, publikojë, qarkullojë, shesë, blejë e administrojë libra, raporte, materiale, gazeta, revista, qarkore dhe publikime të tjera që promovojnë objektivat e Shoqatës dhe të sigurojë, gjenerojë dhe përhapë informacion që është me interes për profesionin e kontabilitetit, kontabilistët e miratuar apo anëtarë të thjeshtë dhe individët e interesuar në profesion.
- (xii) Të promovojë ndërveprime personale të drejtpërdrejta mes personave të përfshirë apo të interesuar në profesionin dhe praktikën e kontabilitetit, duke mundësuar e siguruar ambiente dhe hapësira për dhënie leksionesh, organizimin e studimeve dhe diskutimeve mbi çdo temë, që drejtpërdrejt apo tërthorazi avancojnë objektet e Shoqatës.
- (xiii) Të marrë, pranojë, mbajë dhe përdorë kuotat e anëtarësimit, tarifat e regjistrimit në regjistër, si dhe donacione apo përfitime të tjera të rregullta për të promovuar objektivat e Shoqatës.
- (xiv) Të organizojë veprimtari, aktivitete apo punë të përbashkëta me organizata të ngjashme dhe bashkëpunime me institucione e organizata profesionale brenda e jashtë vendit.
- (xv) Të bashkëpunojë me institucione e organe publike dhe organizata e shoqata të interesuara në fushën e kontabilitetit, çështje të fushës së kontabilitetit, mbi dokumentacionin kontabël, standardet e kontabilitetit, standardet profesionale, rregullimet ligjore për profesionin.

- (xvi) Të kryejë veprimtari të karakterit bamirës apo ndihma humanitare në shërbim të komunitetit të kontabilistëve apo më gjerë, që nuk cenon thelbin e objektivave të Shoqatës dhe misionin e saj.
- (xvii) Të përkrahë dhe mbështesë veprimtarinë e institucioneve arsimore që formojnë profesionistë në fushën e kontabilitetit, financës dhe fushave të tjera të lidhura me to, si dhe të qendrave të formimit profesional apo të përmirësimit dhe rritjes së nivelit teknologjik e të komunikimit.
- (xviii) Të blejë, shesë, japë me qira, barësojë, shkëmbejë, përmirësojë, administrojë dhe/ose të disponojë në çdo lloj mënyre të ligjshme pasuritë e Shoqatës.
2. Objektivat në pikën 1 më sipër mund të modifikohen, ndryshohen dhe/ose zgjerohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.
  3. Edhe pse veprimtaria ekonomike nuk përbën qëllim parësor për Shoqatën, ajo mund të realizojë të ardhura në këmbim të ofrimit të shërbimeve që lidhen me edukimin dhe trajnimin e personave të interesuar në praktikën e kontabilitetit ose fushat e lidhura me të, me kushtin që të ardhurat të përdoren në funksion të avancimit të profesionit dhe disiplinës së kontabilitetit në Shqipëri dhe për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Statut.
  4. Anëtarët e komiteteve apo komisioneve të parashikuara në Statut dhe të krijuar me vendim të Asamblesë ose të Këshillit Drejtues, kanë të drejtën e një shpërblimi fiks për ditë të pjesëmarrjes në veprimtarinë e organit përkatës. Masa e këtij shpërblimi miratohet nga Këshilli Drejtues.
  5. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Shoqatës dhe të komiteteve apo komisioneve, të përmendura në pikën 3 të këtij Neni, gëzojnë të drejtën e rimbursimit për shpenzimet e kryera prej tyre për realizimin e punëve në shërbim të Shoqatës, duke paraqitur dokumente justifikuese.

#### Neni 7

### **Struktura qeverisëse dhe organet e Shoqatës**

1. Organet e Shoqatës janë:
  - a) Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
  - b) Këshilli Drejtues;
  - c) Kryetari i Shoqatës
  - d) Komiteti i Kontrollit të Brendshëm;
  - e) Drejtori Ekzekutiv;
  - f) Degët në rrethe;
2. Organe të Shoqatës janë edhe komitetet dhe komisionet e posaçme të përmendura në Statut.

## Neni 8

**Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve**

1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqatës dhe vendos për sa vijon:
  - a. vendos miratimin apo ndryshimet e statutit;
  - b. përcakton objektin e veprimtarisë dhe misionin e Shoqatës, si dhe mbikëqyr e kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
  - c. zgjedh, emëron dhe shkarkon Kryetarin e Shoqatës;
  - d. zgjedh, emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues;
  - e. zgjedh, emëron dhe shkarkon anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm;
  - f. zgjedh likuidatorin në rast shpërndarje të Shoqatës dhe audituesin ligjor;
  - g. miraton skemën e shpërblimit për personat në pikat “c”, “d” dhe “e” më sipër;
  - h. miraton pasqyrat financiare të aprovuara paraprakisht nga Këshilli Drejtues, ku jepen me hollësi burimet materiale e financiare, përdorimet e tyre dhe pasuritë e Shoqatës;
  - i. miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Shoqatës dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm;
  - j. kontrollon rast pas rasti shpenzimet financiare të kryera nga organizata gjatë realizimit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe ato të kryera për veprimtari të përbashkëta me organizata të tjera;
  - k. miraton Kodin e Etikës së Shoqatës në pajtim me Kodin e Etikës së Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve, që propozohen nga Këshilli Drejtues;
  - l. nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së Shoqatës;
  - m. krijon komitete të posaçme;
  - n. vendos riorganizimin dhe shpërndarjen e Shoqatës;
  - o. mbikëqyr veprimtarinë e Shoqatës, me qëllim parandalimin e përdorimit të burimeve të Shoqatës për qëllime terroriste apo të pastrimit të veprës penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.



## Neni 9

**Mbledhja e Asamblesë**

1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve mbledhet çdo vit brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit pasardhës në “Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore” të organizuar në vendin e caktuar nga Këshilli Drejtues dhe sipas njoftimit për organizimin e Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore, ku parashikohen çështjet për shqyrtim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
2. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në raste të tjera nga ato në pikën 1 të këtij Neni sa herë që konsiderohet e nevojshme, nga Këshilli Drejtues, ose me kërkesën e të paktën 1/10 e anëtarëve të Shoqatës në Mbledhjen e Përgjithshme.
3. Mbledhja e Përgjithshme Vjetore mbahet jo më vonë se 15 muaj nga data e Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore të mëparshme.
4. Anëtarët njoftohen të paktën 30 ditë përpara mbajtjes së Mbledhjes së Asamblesë për organizimin e Asamblesë së Përgjithshme ose Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore. Mosmarrja e njoftimit për arsye që nuk lidhen me Shoqatën, nuk është kusht për pavlefshmërinë e njoftimit dhe nuk përbën kusht për parregullsi në zhvillimin e Mbledhjes.
5. Këshilli Drejtues ngarkon Drejtorin Ekzekutiv si personin përgjegjës për dërgimin e njoftimeve dhe dokumentacionit shoqërues ku përcaktohen koha dhe vendi i zhvillimit të mbledhjes, çështjet e rendit të ditës dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm sipas përcaktimeve të Këshillit Drejtues.
6. Njoftimi në pikën 5 parashikon kohën dhe vendin e mbledhjes dhe çështjet për shqyrtim në Mbledhje, shoqëruar me raportet dhe informacionin e nevojshëm.
7. Anëtarët që dëshirojnë të ngrenë para Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve çështje për shqyrtim, i paraqesin ato më një kërkesë pranë Këshillit Drejtues, në çdo rast jo më vonë se 15 ditë nga dita e caktuar për mbledhjen e radhës. Këshilli Drejtues merr vendim nëse çështja do t'i kalohet mbledhjes së përgjithshme për votim.
8. Punonjësit që shërbejnë si staf apo personel në administratën e Shoqatës, që nuk janë anëtarë të saj, mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë pa të drejtë vote.

## Neni 10

**Rregullat e mbledhjes**

1. Çdo mbledhje e Asamblesë kryesohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues, i cili është Kryetari i Mbledhjes, dhe në mungesë të tij Zëvendëskryetari i Këshillit Drejtues, dhe në mungesë edhe të këtij të fundit, kryetar i mbledhjes caktohet një nga anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues ose nga anëtarët e Shoqatës të pranishëm në mbledhje.

2. Asambleja merr vendim vetëm kur të pranishëm në mbledhje janë më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote, pasi kanë kaluar 30 minuta nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes në njoftim.
3. Në rast se kuorumi në pikën 2 nuk plotësohet, mbledhja shtyhet me të njëjtat çështje me vendim të Këshilli Drejtues, duke bërë të ditur në mbledhje kohën dhe vendin e mbledhjes së radhës. Kur shihet e përshtatshme, Këshilli Drejtues përsërit procedurën e njoftimit edhe për mbledhjen e shtyrë.

#### Neni 11

#### **Votimi në Mbledhjen e Asamblesë**

1. Të drejtën e votës në mbledhjet e përgjithshme të Asamblesë e kanë të gjithë anëtarët individë që kanë shlyer kuotat e detyrueshme të anëtarësisë apo çdo detyrim tjetër ndaj Shoqatës. Të gjithë anëtarët e Shoqatës kanë të drejtën e një vote të barabartë në Mbledhjet e Përgjithshme të Asamblesë, në përputhje me nenin 46 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
2. Çdo anëtar i Shoqatës me të drejtë vote mund të autorizojë një anëtar tjetër të Shoqatës për ta përfaqësuar në mbledhje. Forma dhe përmbajtja e autorizimit përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues, i cili është pjesë e njoftimit për zhvillimin e mbledhjes.
3. Vlefshmëria e votave dhe e procedurës së votimit është në diskrecionin e Drejtuesit të Mbledhjes.
4. Me vendim të Asamblesë, votimi mund të bëhet i fshehtë ose i hapur. Kur votimi bëhet i hapur, Asambleja merr vendim për çështjet që i parashtrihen nëpërmjet votimit me ngritje dore të anëtarëve me të drejtë vote.
5. Kërkesa për zhvillimin e votimit të fshehtë mund të bëhet nga drejtuesi i mbledhjes, ose me kërkesën me shkrim të 10 anëtarëve me të drejtë vote të pranishëm në mbledhje, drejtuar drejtuesit të mbledhjes. Kërkesa miratohet duke votuar me ngritje dore më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote.
6. Në rast barazimi votash, vota e drejtuesit të mbledhjes do të jetë përcaktuese për aprovimin ose jo të çështjes në votim.

#### Neni 12

### **Sekretari i Mbledhjes së Asamblesë**

1. Sekretari i mbledhjes është Drejtori Ekzekutiv dhe në mungesë të tij, një nga anëtarët e Shoqatës që vendos Kryetari i Mbledhjes. Në rolin e sekretarit, Drejtori Ekzekutiv asistohet edhe nga persona të tjerë të caktuar nga drejtuesi i Asamblesë. Sekretari është përgjegjës për:
  - a) verifikimin e rregullsisë së autorizimeve/prokurave që delegojnë të drejtën e përfaqësimit në Mbledhjen e Asamblesë;
  - b) numërimin e votave;
  - c) paraqitjen e një raporti me shkrim të rezultatit të votimit pranë Drejtuesit të Mbledhjes;
  - d) administrimin dhe mbajtjen e autorizimeve/prokurave që delegojnë të drejtën e përfaqësimit në Mbledhjen e Asamblesë për një muaj.
2. Kryetari i Mbledhjes përcakton afatin për përmbushjen e detyrave në pikën 1 nga Sekretari.
3. Vlerësimet dhe përcaktimet e Kryetarit të Mbledhjes dhe Sekretarit gjatë ushtrimit të detyrave përkatëse në Mbledhjen e Asamblesë do të konsiderohen përfundimtare dhe të detyrueshme për Shoqatën.

#### Neni 13

### **Procesverbalet e Mbledhjeve**

1. Procesverbalet e Mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari i Mbledhjes dhe Sekretari i Mbledhjes dhe në mungesë të provave që vërtetojnë të kundërtën, konsiderohen regjistrime të rregullta në Regjistrin e Procesverbaleve.
2. Regjistri i Procesverbaleve të Mbledhjeve të Asamblesë administrohet nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës nën mbikëqyrjen e Këshillit Drejtues.
3. Çdo anëtar njoftohet dhe mund të njihet në çdo kohë me procesverbalet e Mbledhjes së Asamblesë dhe gëzon të drejtën të kërkojë kopje, duke paraqitur kërkesë pranë Drejtorit Ekzekutiv.

#### Neni 14

### **Këshilli Drejtues**

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga nëntë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme Vjetore. Këshilli organizohet dhe funksionon sipas kësaj strukture:
  - a) Kryetari i Këshillit, që është Kryetari i Shoqatës, zgjedhur nga Asambleja;
  - b) Zëvendëskryetari;
  - c) Anëtarë përgjegjës për çështje të tjera, të ndara sipas fushës profesionale.

2. Kryetari i Këshillit Drejtues zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë nga Asambleja e Përgjithshme Vjetore, e cila në të njëjtën mbledhje zgjedh edhe tetë anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues. Kryetari ka mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.
3. Zëvendëskryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit Drejtues të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm pas kalimit të një afati katërvjeçar nga përfundimi i mandatit.

#### Neni 15

#### **Lista e kandidatëve**

1. Çdo anëtar i interesuar që plotëson kushtet, mund të depozitojë dosjen e kandidatit për t'u zgjedhur në Këshillin Drejtues, duke paraqitur kërkesë pranë Drejtorit Ekzekutiv, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar për mbajtjen e mbledhjes së Asamblesë përkatëse. Kërkesa duhet shoqëruar me firmat e të paktën dhjetë anëtarëve të Shoqatës. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të paraqesin kërkesë individuale për kandidimin e tyre për rizgjedhje.
2. Në mbledhjen e Asamblesë, mund të paraqesë një listë kandidaturash Këshilli Drejtues, të cilat i vihen në dispozicion Drejtorit Ekzekutiv, të formalizuara me një vendim të tij. Kandidaturat i paraqiten me shkrim Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e caktuar për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë dhe mbajnë nënshkrimin e Kryetarit të Këshillit Drejtues për kandidaturat e Këshillit ose nënshkrimin e të gjithë anëtarëve propozues për kandidaturat e paraqitura nga dhjetë ose më shumë anëtarë.
3. Lista e kandidatëve për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues, e cila përmban emrin dhe adresën e kandidatëve, përgatitet nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratohet nga Këshilli Drejtues. Lista u njoftohet të gjithë anëtarëve jo më vonë se dhjetë ditë para datës së caktuar për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të radhës.

#### Neni 16

#### **Votimi për Këshillin Drejtues**

1. Pavarësisht parashikimeve në Nenin 11, pika 4, të Statutit, zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit Drejtues në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme Vjetore bëhen me votim të fshehtë.
2. Çdo anëtar me të drejtë vote voton për aq kandidatë (të ndryshëm) sa është numri i vendeve vakante në Këshillin Drejtues. Format i fletëve të votimit miratohet nga Këshilli Drejtues.
3. Kandidatët fitues në zgjedhjet e zhvilluara për anëtarë të Këshillit Drejtues janë ata që marrin numrin më të madh të votave të hedhura të vlefshme. Në rast barazimi votash mes dy anëtarëve

që kandidojnë për vendin vakant në Këshillin Drejtues, përzgjedhja e fituesit bëhet me short, në të njëjtën mbledhje, sipas mënyrës së vendosur nga Kryetari i Mbledhjes.

**Neni 17**

**Vendet vakante në Këshillin Drejtues**

1. Për plotësimin e vendeve vakante të krijuara në Këshillin Drejtues, për arsye dorëheqjeje apo tjetër, Këshilli Drejtues zgjedh ndër anëtarët e Shoqatës që plotësojnë kriteret për të qenë anëtarë të Këshillit kandidaturën, që, duke përjashtuar kandidatët fitues në mbledhjen e mëparshme, ka marrë numrin më të lartë të votave.
2. Anëtarët e zgjedhur si në pikën 1 qëndrojnë në detyrë deri në datën e mbajtjes së Mbledhjes së Asamblesë më të afërt, me të drejtë për t'u rizgjedhur prej asaj Asambleje. Në mbledhjen e asamblesë më të afërt parashikohet si çështje për votim në Mbledhje zgjedhja e anëtarit/ve për plotësimin e vendit vakant në Këshillin Drejtues, duke zbatuar parashikimet përkatëse të Statutit.

**Neni 18**

**Përbërja e Këshillit Drejtues**

1. Më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit Drejtues janë Kontabilistë të Miratuar Aktivë. Anëtar i Këshillit Drejtues mund të zgjidhet një anëtar i Shoqatës që plotëson kushtet që vijojnë:
  - a) gëzon shëndet dhe aftësi të plota, pa të cilat ushtrimi i detyrave në Këshillin Drejtues do ishte i pamundur;
  - b) nuk është marrë kundër tij/saj asnjë masë disiplinore, që e përjashton atë nga anëtarësia në Shoqatë;
  - c) në datën e paraqitjes së kërkesës/kandidaturës për të marrë pjesë në zgjedhje, kandidati rezulton se ka paguar kuotat e anëtarësisë dhe çdo detyrim tjetër ndaj Shoqatës;
  - d) gjatë periudhës katërvjeçare para paraqitjes së kërkesës/kandidaturës për të marrë pjesë në zgjedhje nuk ka qenë subjekt i masave disiplinore/ndëshkuese të marra nga Shoqata, nga organet publike apo gjykatat në lidhje me ushtrimin e veprimtarive në fushën e kontabilitetit apo fushave të tjera të lidhura me të.

## Neni 19

**Detyrat e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli Drejtues kryen drejtimin e veprimtarisë, në pajtim me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, së cilës edhe i raporton për veprimtarinë e tij dhe është përgjegjës për sa më poshtë:
  - a) punon për arritjen e objektivave të Shoqatës të parashikuara në Nenin 3;
  - b) miraton politikat e edukimit të vijueshëm si dhe mënyrën e organizimit, e monitorimit dhe të vlerësimit individual të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të saj, si dhe rregullat për regjistrimin dhe çregjistrimin e anëtarëve nga Regjistri i Kontabilistëve të Miratuar;
  - c) siguron mbarëvajtjen financiare të organizatës dhe ushtrimin e veprimtarisë së saj në përputhje me qëllimin e deklaruar;
  - d) përfaqëson Shoqatën nëpërmjet Kryetarit në marrëdhënie me subjektet, private ose publike, të tilla si donatorë, klientë furnizues apo subjekte të tjera private, organizata profesionale vendase dhe të huaja, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e Shoqatës;
  - e) krijon sistemin e kontrollit të cilësisë së punës së Kontabilistëve të Miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit dhe kryen investigime në rastet e shkeljeve të standardeve profesionale teknike dhe etike, si dhe udhëheq sistemin e investigimit e të disiplinës për aspekte të tjera brenda objektit të vet;
  - f) miraton listën përfundimtare të kandidaturave për zgjedhje në Këshillin Drejtues dhe Komitetin e Kontrollit të Brendshëm;
  - g) miraton masën e kuotave të anëtarësisë dhe të tarifave të regjistrimit të aplikueshme nga Shoqata;
  - h) vendos dhënien e titujve honorifikë për anëtarët e shoqatës, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për profesionin e kontabilitetit dhe shërbimeve të tjera të lidhura me to;
  - i) emëron, shkarkon dhe përcakton shpërblimin e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës;
  - j) miraton politikat e edukimit të vijueshëm si dhe mënyrën e organizimit, e monitorimit dhe të vlerësimit individual të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të Shoqatës;
  - k) miraton dhe mbikëqyr organizimin e testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme;
  - l) miraton organizimin dhe programet e testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme;
  - m) harton rregulloret dhe aktet e brendshme të Shoqatës për miratim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
  - n) jep tituj nderi për profesionistë dhe kontribuues të dalluar në fushën e kontabilitetit apo fushave të lidhura me të;
  - o) propozon kandidatë përfaqësues të Shoqatës në struktura dhe funksione publike;

- p) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale, nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste;
- q) kryen detyra të tjera të caktuara me ligj apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, ose kur kërkohet nga autoritetet publike, rregullatore të praktikës së kontabilitetit.

**Neni 20**

**Kryetari i Shoqatës**

1. Kryetari i Këshillit Drejtues është njëkohësisht Kryetar i Shoqatës dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Kryetari promovon dhe bashkërendon veprimtaritë e Shoqatës dhe siguron që ajo të funksionojë mirë dhe në përmbushje të misionit të saj.
2. Kryetari i Shoqatës është organi që përfaqëson ligjërisht Shoqatën me palët e treta, vepron si përfaqësues zyrtar i Shoqatës gjatë takimeve dhe ngjarjeve zyrtare, si edhe, por pa u kufizuar, sa vijon:
  - a) thërret dhe kryeson mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të Asamblesë së Përgjithshme;
  - b) cakton agjendën vjetore të Shoqatës;
  - c) krijon buxhetin dhe menaxhon financat dhe pasuritë e Shoqatës;
  - d) nënshkruan dhe/ose kundërfirmos të gjitha aktet përkatëse të miratuara nga organet drejtuese të Shoqatës.
3. Në mungesë të Kryetarit të Këshillit Drejtues, Zëvendëskryetari e zëvendëson atë në detyrat e parashikuara në Statut apo me vendim të Këshillit.

**Neni 21**

**Mbledhjet e Këshillit Drejtues**

1. Me kërkesë të Kryetarit, ose në mungesë të tij, të Zëvendëskryetarit, Këshilli Drejtues mbledhet sa herë që interesat e Shoqatës e kërkojnë, por si rregull katër herë në vit (një herë në çdo tre muaj).
2. Kryetari duhet të thërrasë Këshillin Drejtues brenda një afati të arsyeshëm kur një e treta e anëtarëve të Këshillit, me kërkesë të motivuar, i drejtohen Kryetarit për t'u takuar. Njoftimet për mbledhjen përmendin rendin e ditës dhe pikat kryesore për diskutim. Në rast se Kryetari nuk arrin të thërrasë Këshillin Drejtues brenda dhjetë ditëve nga marrja e kërkesës, kërkuesit mund të thërrasin dhe të drejtojnë mbledhjen e Këshillit Drejtues duke përcaktuar çështjet e rendit të ditës së mbledhjes.

3. Në rrethanat kur mbledhja e Këshillit Drejtues nuk mund të realizohet nëpërmjet takimit fizik të anëtarëve apo kur kjo nuk lejohet dhe nuk rekomandohet, mbledhja e Këshillit Drejtues zhvillohet nëpërmjet platformave online.
4. Mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahen brenda Republikës së Shqipërisë siç tregohet në njoftimin e mbledhjes dhe mund të realizohen edhe nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës ose me mjete të ngjashme elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe të komunikojnë në mënyrë të qartë. Nëse plotësohen këto kushte, mbledhja e Këshillit konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari.
5. Procesverbalet e mbledhjeve mbahen nga sekretari i mbledhjes që si rregull caktohet nga Drejtori Ekzekutiv ose, në mungesë të tij, një anëtar i Shoqatës i përzgjedhur nga Këshilli dhe nënshkruhen nga ai/ajo dhe Kryetari, ose në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari. Procesverbalet mbahen në regjistër të veçantë të administruar nga Drejtori Ekzekutiv.

**Neni 22**

**E drejta e informimit**

1. Çdo anëtar i Shoqatës mund të njihet me procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit, duke i dërguar kërkesë Kryetarit të Këshillit Drejtues.

**Neni 23**

**Vendimet e Këshillit Drejtues**

1. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje me shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe, në rast barazimi, vota e Kryetarit është përcaktuese.
3. Vendimet (procesverbalet) e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.
4. Vendimet e Këshillit Drejtues pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes dhe përbëjnë dokumente përfundimtare dhe të detyrueshme të Shoqatës. Anëtarët e Shoqatës informohen për vendimet e marra nga Këshilli Drejtues sipas mënyrës së përcaktuar nga Këshilli.

**Neni 24**

**Komiteti i Kontrollit të Brendshëm**



1. Për të garantuar mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, të procedurave administrative dhe kontabël, si dhe për të respektuar rregullat e kontrollit të brendshëm të Shoqatës, krijohet Komiteti i Kontrollit të Brendshëm, si organ i pavarur nga Këshilli Drejtues, i zgjedhur nga Asambleja e Anëtarëve.
2. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm zgjidhen me votim të fshehtë në bazë të paraqitjes individuale të kandidaturave. Rregullat që zbatohen për zgjedhjen e Këshillit Drejtues në Mbledhjen e Asamblesë zbatohen edhe për anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm, të cilët duhet të përmbushin të njëjtat kushte me anëtarët e Këshillit Drejtues.
3. Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë, që emërohen nga Asambleja për një periudhë trevjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit janë individë, të cilët, pavarësisht pikës 1, duhet të kenë eksperiencë jo më pak se 5 vjet në fushën e financës, auditimit, kontabilitetit apo fushave të tjera të lidhura me to.
5. Komiteti i Kontrollit ka këto detyra:
  - a) kontrollon zbatimin e ligjshmërisë dhe akteve të tjera normative në veprimtarinë e shoqatës;
  - b) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të Shoqatës;
  - c) mbikëqyr rezultatet e auditimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
  - d) sigurohet që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar;
  - e) kontrollon llogaritë dhe regjistrimet përkatëse financiare të Shoqatës;
  - f) bën vlerësimin e situatës financiare të Shoqatës, bazuar në raportin e audituesit ligjor;
  - g) i paraqet Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve në Mbledhjen Vjetore një raport vjetor të veprimtarisë dhe situatës financiare të Shoqatës;
  - h) i jep mendim Këshillit Drejtues për çështjet të caktuara që kërkohet prej tij.
6. Kryetar i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm caktohet kandidati që fiton numrin më të madh të votave dhe në rast votash të barabarta, kandidati që ka më shumë vite eksperiencë në profesion.
7. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve shkarkon anëtarët e Komitetit të Kontrollit në rastet kur me veprimet apo mosveprimet e tyre, të cilat bien ndesh me statutin, ligjin dhe rregullat e

profesionit, kanë cenuar rëndë reputacionin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe të Shoqatës.

8. Anëtari i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm e humbet automatikisht cilësinë e tij si anëtar në Komitet në rastet kur pushon së qeni anëtar i Shoqatës apo ndaj tij është aplikuar një dënim penal, ose kur ndëshkohet me masë disiplinore “*pezullim*” për një periudhë kohe të caktuar ose përjashtim nga Shoqata.
9. Komiteti i Kontrollit të Brendshëm mblidhet sa herë që e gjykon të nevojshme dhe të paktën një herë në vit për shqyrtimin e llogarive vjetore dhe dorëzimin e raportit lidhur me to apo kur i kërkohet mendim nga Këshilli Drejtues për probleme të veçanta. Kur kërkohet nga Këshilli, Komiteti i Kontrollit të Brendshëm mblidhet dhe paraqet raportin përkatës jo më vonë se 2 muaj nga marrja e kërkesës.
10. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues, që kanë si rend dite çështje që lidhen me detyrat e Komitetit, por pa të drejtë vote.

#### Neni 25

#### **Kontrolli i cilësisë së shërbimeve të kontabilitetit**

1. Kontrolli i cilësisë së shërbimeve të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të lidhura me to realizohet nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë, që funksionon si strukturë e posaçme pranë Shoqatës.
2. Nëpërmjet këtij Komiteti, Shoqata krijon një sistem kontrolli për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të kontabilitetit, të bazuar në politika dhe procedura të brendshme, që kanë si qëllim garantimin e cilësisë së përgjithshme të shërbimeve të kontabilitetit, të ofruara nga Kontabilistët e Miratuar Aktivë dhe pjesa tjetër e anëtarësisë që ofrojnë shërbime ndaj çdo marrësi të shërbimeve.
3. Kontrolli i cilësisë përfshin realizimin e një vlerësimi objektiv të përputhshmërisë me standardet e zbatueshme të kontabilitetit dhe kërkesat e etikës dhe të pavarësisë, të cilësisë dhe sasisë së burimeve të shpenzuara, të tarifave të ngarkuara për shërbimet dhe një vlerësim të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të shoqërive të kontabilitetit.
4. Kontrolli i cilësisë kryhet nga anëtarë të Shoqatës, të cilët janë Kontabilistë të Miratuar të caktuar për kontrole të veçanta nga Komisioni i Kontrollit të Cilësisë në përputhje me kushtet dhe procedurat e Këshillit Drejtues.
5. Kontrolli i cilësisë shoqërohet me përgatitjen e një raporti nga kontrolluesi, që përmban konkluzionet kryesore të kontrollit të kryer. Ky raport i paraqitet Komisionit të Kontrollit të Cilësisë, i cili për rastet e parashikuara apo kur është e nevojshme të merren masa të caktuara, raporton pranë Këshillit Drejtues.

6. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë përzgjedh kontrolluesit që:
  - a) kanë eksperiencë të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit;
  - b) sjellja e tyre vjen në përputhje me Kodin e Etikës së Shoqatës;
  - c) nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit.
7. Këshilli Drejtues dhe Komisioni i Kontrollit të Cilësisë kujdesen që Shoqata të përmbushë të gjitha kërkesat rregulative të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në realizimin e kontrolleve të cilësisë dhe që këto kontrolle organizohen në mënyrë që të jenë të pavarura dhe të pandikuara nga Kontabilistët e Miratuar apo Shoqëritë e Kontabilitetit objekt kontrolli.
8. Këshilli Drejtues përcakton me rregullore të posaçme, e cila miratohet nga Asambleja e Anëtarëve, rregulla të hollësishme të funksionimit të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë, përzgjedhjen e kontrolluesve, shpërblimin e tyre dhe procedurat për marrjen e vendimeve.

Neni 26  
**Drejtori Ekzekutiv**

1. Drejtori Ekzekutiv siguron mbarëvajtjen e punëve administrative, mbulimin e tyre dhe të veprimtarive të tjera të Shoqatës në përputhje me rregullat e administrimit financiar, të miratuara nga Këshilli Drejtues. Ai është përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative në veprimtarinë e Shoqatës që kanë të bëjnë me administrimin financiar të mjeteve në dispozicion të saj.
2. Drejtori Ekzekutiv organizon punën për kryerjen e veprimtarive profesionale të Shoqatës, të cilat janë në përputhje me Ligjin apo me vendimet e Këshillit Drejtues, si dhe mbulon detyrat e parashikuara në Statut dhe Veprimtarinë teknike e profesionale në zbatim të programit të punës dhe të vendimeve të Këshillit Drejtues.
3. Drejtori Ekzekutiv raporton rregullisht para Këshillit Drejtues mbi gjendjen financiare të Shoqatës, realizimin e buxhetit shoqëruar me pasqyrat financiare periodike dhe për detyrat që i janë caktuar.
4. Drejtori Ekzekutiv, me kërkesë të Këshillit Drejtues, kryen detyra të tjera dhe që lidhen me veprimtarinë e Shoqatës.
5. Drejtori Ekzekutiv është punonjës me kontratë dhe shpërblehet për punët e kryera për Shoqatën sipas vendimit të Këshillit Drejtues.

Neni 27  
**Degët e Shoqatës**

1. Shoqata, me vendim të Këshillit Drejtues, mund të krijojë degë të saj në çdo njësi administrativo-territoriale të Shqipërisë. Këto degë nuk janë persona juridikë të veçantë, por pjesë e Shoqatës dhe kryejnë veprimtaritë që i caktohen nga Këshilli dhe organet drejtuese.
2. Degët e Shoqatës krijohen mbi bazë bashkie ose qarku kur brenda njësisë territoriale ndodhen mbi 10 anëtarë të Shoqatës, të cilët regjistrohen pranë degës përkatëse.
3. Anëtarët e Shoqatës të regjistruar në një degë formojnë Asamblenë e Degës, e cila mbledhet të paktën një herë në vit dhe thirret nga Kryetari i Degës, Këshilli Drejtues apo 1/3 e anëtarëve të Degës.
4. Asambleja e Degës ka këto kompetenca kryesore:
  - a) Zgjedh Kryetarin e Degës dhe Sekretarin e Degës;
  - b) Shqyrton dhe miraton raportin e funksionimit të Degës;
  - c) Mbikëqyr zbatimin e objektivave të degës dhe detyrave të Këshillit Drejtues brenda rajonit gjeografik që përfshin dega;
  - d) Organizon në bashkëpunim me Këshillin Drejtues dhe organet e tjera të saj veprimtari dhe aktivitete, që janë në përputhje me misionin dhe objektin e saj të veprimtarisë.
5. Rregullat e zgjedhjes në mbledhjen e Asamblesë së Degës dhe forma e votimit përcaktohen me vendim të Asamblesë së Degës, në përputhje me këtë statut.
6. Dega e Shoqatës drejtohet nga Kryetari i Degës, i cili ka mandat katërvjeçar me të drejtë përsëritje. Në çdo Degë zgjidhet edhe një sekretar me shumicë të thjeshtë votash, me mandat katërvjeçar, me të drejtë përsëritjeje.
7. Kryetari i Degës është përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Degës në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Shoqatës dhe udhëzimet e Këshillit Drejtues. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen e regjistrave dhe dokumentacionit në Degë.
8. Këshilli Drejtues vendos nën diskrecionin e vet fondet për mbulimin e shpenzimeve të Degëve në përputhje me objektivat e Shoqatës.
9. Degët organizohen, veprojnë dhe administrohen në përputhje me Statutin dhe rregullat përkatëse të Asamblesë së Degës dhe Shoqatës.

#### Neni 28

#### **Komiteti i Regjistrimit**

1. Shoqata krijon Komitetin e Regjistrimit si strukturë e posaçme që merret me procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit në regjistrin publik të Kontabilistëve të Miratuar dhe Shoqërive të Kontabilitetit.

2. Komiteti i Regjistrimit përbëhet nga katër anëtarë të Shoqatës, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues për një periudhë trevjeçare. Një nga anëtarët e Komitetit të Regjistrimit është gjithashtu anëtar i Këshillit Drejtues.
3. Këshilli Drejtues përcakton me rregullore të posaçme rregulla të hollësishme të funksionimit të Komitetit të Regjistrimit, shpërblimin e anëtarëve të Komitetit dhe procedurat për marrjen e vendimeve dhe miratimet e regjistrimeve. Rregullorja miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve në përputhje me parashikimet në statut.
4. Komiteti i Regjistrimit administron dhe mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe përmbush detyrat sipas rregullores në pikën 3 të këtij neni.

#### Neni 29

### **Regjistri i Anëtarëve dhe Regjistri i Kontabilistëve të Miratuar**

1. Shoqata mban Regjistrin e Anëtarëve që përfshin të gjithë anëtarët e Shoqatës dhe Regjistrin e Kontabilistëve të Miratuar të Shoqatës, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, të cilin Këshilli mund ta publikojë çdo vit ose me ato intervale që gjykon të përshtatshme.
2. Nuk lejohet regjistrimi në Regjistrin e Kontabilistëve të Miratuar të Shoqatës i individit apo shoqërisë së kontabilitetit, që nuk përmbush kushtet e përcaktuara në Ligjin “Për auditimin ligjor” ose në Statut. Regjistri i Kontabilistëve të Miratuar mban emrin, adresën personale dhe adresën e aktivitetit tregtar të çdo anëtari.
3. Shoqata publikon listën e Kontabilistëve të Miratuar Aktivë dhe Jo-Aktivë. Me vendim të Këshillit Drejtues, regjistri i Kontabilistëve të Miratuar mund të përmbajë të dhëna të tjera të përshtatshme në lidhje me anëtarët në Regjistër. Këshilli Drejtues siguron që informacioni në Regjistër të jetë i aksesueshëm dhe i disponueshëm për çdo anëtar, subjekte publike e private, organizatë ose autoritet.
4. Këshilli Drejtues përcakton me rregullore të posaçme rregulla të hollësishme për regjistrimin dhe çregjistrimin e anëtarëve në përputhje me Ligjin “Për auditimin ligjor” dhe rregulloret e Bordit të Mbikëqyrjes, shpërblimin e anëtarëve të Komitetit dhe procedurat për marrjen e vendimeve dhe miratimet e regjistrimeve. Rregullorja miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve në përputhje me parashikimet në statut.

#### Neni 30

### **Procedimi disiplinor**

1. Procedimi disiplinor garanton ushtrimin e profesionit të kontabilistit sipas standardeve teknike dhe respektimin e kodeve etike prej anëtarëve të Shoqatës dhe mbrojtjen e të drejtave të

konsumatorit të shërbimeve të kontabilitetit, si dhe të çdo subjekti tjetër që lidhet me këtë profesion.

2. Pranë Shoqatës funksionon Komisioni Disiplinor, me qëllim sigurimin dhe ruajtjen e standardeve të domosdoshme në ushtrimin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe marrjen e masave disiplinore ndaj Kontabilistëve të Miratuar të anëtarësuar në Shoqatë, apo anëtarëve të tjerë që shkelin rëndë ose në mënyrë të përsëritur dispozitat ligjore për ushtrimin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar, Statutin ose Kodin e Etikës të Shoqatës.
3. Komisioni Disiplinor përbëhet nga katër anëtarë të Shoqatës, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues për një periudhë trevjeçare. Komisioni disiplinor shqyrton ankesat që i paraqiten për shqyrtim, duke vepruar si një strukturë e pavarur dhe çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të shprehet mbi rastet sipas bindjes së tij. Në rast mosmarrëveshje, secili anëtar paraqet veçmas mendimet dhe vlerësimet e tij pranë Këshillit Drejtues, i cili merr vendimin përfundimtar në lidhje me çështjen.
4. Komisioni Disiplinor është përgjegjës për investigimin e ankesave dhe propozimin e masave disiplinore ndaj anëtarëve. Komisioni shqyrton ankesat e paraqitura ndaj anëtarit: kontabilist i miratuar, shoqëri kontabiliteti apo ndaj çdo anëtari të veçantë. Komisioni Disiplinor mund të fillojë edhe investigime bazuar në burime të tjera informacioni në përputhje me rregulloren e procedimit disiplinor. Afatet e shqyrtimit të ankimeve, kuorumi i nevojshëm për mbledhjen, mënyra e votimit dhe marrja e vendimeve përcaktohen në rregulloren e procedimit disiplinor të miratuar nga Këshilli Drejtues.
5. Objekt i procedimit disiplinor janë ata anëtarë të Shoqatës që gjatë ushtrimit të profesionit:
  - a) kryejnë veprime të paligjshme ose aktivitet kriminal;
  - b) kryejnë veprime që çojnë në diskreditimin e profesionit;
  - c) shkelin standardet profesionale ose Kodin e Etikës të Shoqatës (në pajtueshmëri me Kodin e Etikës së IFAC);
  - d) shfaqin neglizhencë të madhe profesionale, duke dhënë shërbime kontabiliteti të gabuara, të papërshtatshme, me mangësi, me të meta të mëdha;
  - e) shkelin rregullat, vendimet dhe të gjitha aktet e hartuara apo të miratuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
  - f) kanë shkelur ligjin dhe/ose Statutin.
6. Për shkeljen e standardeve profesionale të anëtarit “Kontabilist i Miratuar”, ose të çdo anëtari, të dispozitave ligjore, dhe/ose të këtij Statuti, Komisioni Disiplinor i propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave disiplinore si vijon:
  - a) Qortim;
  - b) Vërejtje me shkrim;

- c) Pezullim/çregjistrim nga Regjistri i Shoqatës së Kontabilistëve të Miratuar;
  - d) Përrjashtim nga Shoqata.
7. Këshilli Drejtues harton rregulloren e procedimit disiplinor, në të cilën parashikohen rregulla të hollësishme për fillimin e procedimit disiplinor dhe që lidhen me regjistrimin e ankesave, plotësimin e tyre me provat e nevojshme, vlerësimin, njoftimin e subjekteve në ankesë, funksionimin e Komisionit Disiplinor, investigimin dhe dërgimin e relacionit dhe rekomandimeve pranë Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Rregullorja miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve në përputhje me parashikimet në statut.
8. Në hartimin e rregullores, në pikën 7 më sipër Këshilli Drejtues bazohet sa është e mundur në parimet, rregullat dhe kriteret e vendosura nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

#### Neni 31

#### **Largimi dhe humbja e anëtarësisë në Shoqata**

1. Çdo anëtar që dëshiron të tërhiqet nga anëtarësia, duhet të njoftojë me shkrim Këshillin Drejtues dhe me marrjen e njoftimit humbet dhe anëtarësia. Anëtari që bën njoftimin, sigurohet të ketë shlyer çdo detyrim të lindur ndaj Shoqatës.
2. Nuk pranohet njoftimi në pikën 1 në rastet kur kundër anëtarit është regjistruar ankesë, për të cilën nuk është marrë vendim përfundimtar sipas parashikimeve të rregullores për procedimin disiplinor.
3. Anëtari pushon së qeni anëtar i Shoqatës nëse në mënyrë të përsëritur nuk paguan kuotat e anëtarësisë ose detyrime të tjera apo për shkelje të rënda të Statutit, ligjit dhe detyrimeve si anëtar i Shoqatës.
4. Anëtarit të Shoqatës, që, për çdo arsye pushon së qeni i tillë, nuk i rikthehen pagesat e bëra për kuotat e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit në regjistër apo tarifa të tjera të miratuara nga Shoqata.

#### Neni 32

#### **Shpërndarja e Shoqatës**

1. Shpërndarja e Shoqatës bëhet:
  - a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të saj;
  - b) kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar në Statut;
  - c) kur qëllimi i shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet më;

- d) kur vërtetohet se shoqata ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme, konfirmuar me vendim të formës së prerë;
  - e) në raste të tjera të parashikuara nga ligji.
2. Kur vendoset shpërndarja e Shoqatës, ajo vihet në likuidim dhe çregjistrohet sipas rregullave të parashikuara në ligj për shoqatat. Pasuria e Shoqatës e mbetur pas likuidimit të detyrimeve destinohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve për bamirësi ose te një/disa nga organizatat profesionale në Shqipëri që kanë objektiva të përafërta me Shoqatën.

### Neni 33 **Llogaritë vjetore**

1. Këshilli Drejtues siguron që aktiviteti dhe veprimtaritë e Shoqatës të mbahen dhe të dokumentohen rregullisht dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e kontabilitetit.
2. Pasqyrat financiare nënshkruhen nga Kryetari i Shoqatës dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare i emëruar për këtë detyrë nga Këshilli Drejtues. Personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare është personi i punësuar pranë Shoqatës dhe i licencuar si Kontabilist i Miratuar apo Auditues Ligjor në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.
3. Në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore paraqiten pasqyrat vjetore të performancës financiare të Shoqatës, të përgatitura për vitin ushtrimor paraardhës, së bashku me raportin e audituesit apo audituesve. Çdo anëtar i Shoqatës ka të drejtë të njihet me këto pasqyra dhe raportin e audituesit.
4. Teprica e të ardhurave mbi shpenzimet e çdo viti mbartet në vitin e ardhshëm ose mund të kalojë në rezervën e përgjithshme apo në një rezervë të posaçme të Shoqatës, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve. Në rast se për një vit shpenzimet rezultojnë më të mëdha se të ardhurat, mbetja deficitare kalon në pakësim të rezervës ose mbartet në ushtrimin e ardhshëm sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.
5. Shoqata cakton në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore një/disa auditues ose shoqëri auditimi për auditimin e pasqyrave të Shoqatës, të cilët rrinë në detyrë deri në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të radhës.
6. Auditues i emëruar si më sipër është në çdo rast një auditues ose shoqëri auditimi e regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për auditimin ligjor”.
7. Shpërblimi i audituesit përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues.



8. Nuk lejohet emërimi si auditues i personave më poshtë:
- a) Anëtarët e Këshillit Drejtues;
  - b) Drejtori Ekzekutiv;
  - c) Anëtarë të Shoqatës që kryejnë rregullisht punë për Shoqatën.

**Neni 34**

**Dispozita të përgjithshme**

1. Ky statut miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i cili mbikëqyr edhe organizimin dhe funksionimin e Shoqatës.
2. Interpretimi i dispozitave të këtij Statuti bëhet duke iu referuar kuptimit të dispozitave përkatëse në Ligjin “Për auditimin ligjor” i ndryshuar me Ligjin 47/2016, në rregulloret e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në Ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar, dhe në dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
3. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi, në veçanti Ligji “Për auditimin ligjor” i ndryshuar me Ligjin 47/2016, Ligji 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar dhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

**Neni 35**

**Dispozita kalimtare dhe të fundit**

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, sipas pikës 1 të nenit 34, Kryetari i Shoqatës dhe anëtarët e Këshillit Drejtues në detyrë qëndrojnë në këtë funksion deri në mbarim të afatit të tyre.
2. Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe zëvendësimi dhe emërimi i anëtarëve të rinj në Këshillin Drejtues bëhet në përputhje me parashikimet në këtë statut.